REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Raporti Vjetor
2016

Lënda

Seksioni 1 – Hyrje 4

1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit dhe Drejtorit të Përgjithshëm 4

1.2. Përmbledhje ekzekutive 6

Seksioni 2 - ASD fiton çmimin e IADI "Përmirësimet e Sistemit të Sigurimit të Depozitave". 7

Seksioni 3 - Vështrim i përgjithshëm mbi depozitat 9

3.1. Sistemi bankar, disa tregues kryesorë 9

3.2. Depozitat në sistem 10

3.2. Depozitat e siguueshme 10

3.3. Depozitat e siguruara 13

Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare 16

4.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka 16

4.2. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK 16

4.3. Treguesit kryesorë financiarë 17

4.4. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në banka 19

4.5. Administrimi i mjeteve financiare 19

4.6. Administrimi i burimeve financiare 21

4.6.1. Rregullorja e re "Për politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare" 21

4.6.2. Marrëveshjet e huasë 22

Seksioni 5 - Projektet kryesore për vitin në raportim. 23

5.1. Procesi i përfshirjes së SHKK-ve në skemën e sigurimit të depozitave. 23

5.2. Zgjerimi i skemës dhe përmirësimi e përshtatja e infrastrukturës ligjore dhe rregullative. 24

5.2.1. Përfshirja në skemë e tregtarëve dhe shoqërive tregtare. 24

5.2.2. Roli i Agjencisë në ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka. 25

5.3. Forcimi i efikasitetit profesional dhe gatishmërisë 26

5.3.1. Udhëzimi i Bankës së Shqipërisë nr. 4187, datë 1.09.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3241, datë 18.12.2014 "Për sigurimin e depozitave në banka" 26

5.3.2. Udhëzimi i Bankës së Shqipërisë nr. 4188, datë 1.09.2016 "Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit". 26

5.3.3. Vendimi i Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 26, datë 17.10.2016 "Për miratimin e formatit standart të të dhënave për bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit". 27

5.3.4. Rregullorja nr. 3762, datë 18.7.2016 "Për kompensimin e depozitave të siguruara"....27

5.3.5. Plani i veprimit për kompensim 27

5.4. Administrimi financiar i Agjencisë 28

5.5. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut....29

5.5.1. Zhvillimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me anëtarët e skemës dhe subjektet rregullatore financiare. 29

5.5.2. Komunikimi i vazhdueshëm dhe efektiv me grupet e synuara. 30

5.6. Zhvillimi marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare të sigurimit të depozitave dhe agjencitë homologe....31

5.6.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar 31

5.6.2. Marrëveshja rajonale shumëpalëshe e bashkëpunimit. 32

Seksioni 6 – Mirëqeverisja e organizatës....33

6.1. Këshilli Drejtues....33

6.2. Struktura organizative 34

6.3. Auditi i brendshëm 35

Seksioni 1 – Hyrje

1.1. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit dhe Drejtorit të Përgjithshëm

Gjatë vitit 2016, sektori bankar shqiptar u karakterizua nga një ecuri e shëndetshme dhe e qëndrueshme. Ashtu si dhe në vitet e kaluara, ky sektor transmeton qartësi dhe siguri për depozituesit shqiptarë, dhe si i tillë gëzon besimin e tyre. Megjithatë, Agjencia e Sigurimit të Depozitave mbetet e angazhuar për zhvillimin e kapaciteteve të saj dhe gatishmërisë operacionale për përballimin e çdo situate vështirësie, për të garantuar përmbushjen me efektivitet të mandatit të saj në çdo kohë.

Dëshmi për përmirësimet e vazhdueshme në funksion të krijimit të një skeme sa më të sigurtë dhe në përputhje me parametrat më bashkëkohorë të sigurimit të depozitave, është çmimi "Për përmirësimet e sistemit të sigurimit të depozitave" i IADI (Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave), i cili u fitua nga Agjencia në vitin 2016. Në marrjen e këtij çmimi shumë të rëndësishëm Agjencia u vlerësua për përmirësimet thelbësore në të gjithë elementët që formojnë një skemë sa më të sigurtë për depozituesit e siguruar. IADI është organizata botërore me anëtarësinë e 83 shteteve që përcakton standardet ndërkombëtare të sigurimit të depozitave.

Në vitin 2016, Agjencia ka bërë progres në drejtim të treguesve kryesorë të performancës të parashikuar në Planin Strategjik 2015-2017. Agjencia forcoi gatishmërinë institucionale për kompensim, nëpërmjet ushtrimeve të simulimeve teknike dhe përmirësimit më tej të kuadrit ligjor dhe rregullativ për kompensimin e depozituesve në rast nevoje. Në aspektin financiar, për vitin 2016 u planifikua një buxhet sfidues por dhe realist i cili u realizua në përputhje me parashikimin në Planin Strategjik 2015-2017, si dhe u administrua me efikasitet fondi i sigurimit të depozitave në përputhje me parimet e likuiditetit dhe sigurisë.

Në përputhje me rekomandimet e lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës "Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2015", në vitin 2016 Agjencia përmirësoi kuadrin ekzistues të akteve nënligjore për kompensim dhe konsolidoi infrastrukturën informatike për pagesën e shpejtë dhe të saktë të depozituesve në rast të një ngjarjeje sigurimi. Gjithashtu, Agjencia u investua në rritjen e nivelit të edukimit dhe ndërgjegjësimit të depozituesve për përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave, si dhe njohjen e tyre me procedurën e kompensimit, nëpërmjet trajnimeve dhe publikimit të materialeve promocionale. Në këtë kontekst, u punua edhe për rritjen e prezencës së Agjencisë në mediumet më të fundit për komunikim me publikun, si mediat sociale dhe faqja zyrtare e internetit

Një tjetër element i rëndësishëm për skemën në vitin 2016, njëkohësisht rekomandim i Rezolutës së Kuvendit por dhe praktikë e njohur ndërkombëtare, ishte zgjerimi i skemës me tregtarët, personat juridikë si dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Agjencia asistoi intensivisht në procesin e përgatitjes së shoqërive të kursim-kreditit, për përmbushjen nga ana e tyre të kritereve ligjore, për përfshirjen në skemën e sigurimit të depozitave. Në këtë kontekst, spektri i depozituesve që përfitojnë nga skema

është zgjeruar konsiderueshëm, duke kontribuar kështu në besimin e tyre në sistemin bankar e financiar, por edhe në stabilitetin e këtij të fundit.

Gjatë vitit 2016, Agjencia u investua gjithashtu si pjesë e disa projekteve me rëndësi të Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore. I tillë ishte ligji i ri për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në të cilin Agjencia ka dhënë kontribut të qenësishëm në konceptimin e tij duke luajtur një rol të rëndësishëm në konsultimet, diskutimet dhe si pjesë e grupit të punës për hartimin e ligjit, i cili u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në fund të vitit 2016. Sipas ligjit, ndër të tjera, Agjencia do të jetë administruese e vetme e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj.

Në kuadrin e bashkëpunimit në nivel kombëtar, Agjencia ka qenë gjithashtu pjesë e vazhdueshme e mbledhjeve të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, së bashku me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Në këto mbledhje, Agjencia ka luajtur rol aktiv nëpërmjet kontributit në lidhje me ecurinë e depozitave të sistemit bankar dhe fondit të sigurimit të depozitave.

Në aspektin ndërkombëtar, gjatë vitit 2016 Agjencia ka vazhduar angazhimin e saj në marrëdhëniet me organizmat ndërkombëtare ku ajo bën pjesë, duke synuar përditësimin e skemës me tiparet më të avancuara në fushën e sigurimit të depozitave. Bashkëpunimi rajonal me institucionet homologe ballkanike ka qenë gjithashtu pjesë integrale e këtyre aktiviteteve, dëshmi për të cilën është marrëveshja gjashtë palëshe e bashkëpunimit e nënshkruar nga Agjencia me homologët tanë nga Mali i Zi, Kroacia, Serbia, Bosnja dhe Maqedonia.

Për vitin 2017 do të vazhdojmë me vendosmëri punën për përmbushjen e objektivave të tjera të Agjencisë, siç janë intensifikimi i simulimeve për të testuar gatishmërinë e institucionit për kompensim, përgatitja për detyrat e Agjencisë në kuadër të ligjit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, angazhimi mëtejshëm për edukimin dhe ndërgjegjësimin e vazhdueshëm të publikut të gjerë mbi skemën e sigurimit të depozitave.

Gjithashtu, gjatë 2017 do të synojmë që, në koordinim me institucionet e tjera përgjegjëse dhe subjektet e sistemit bankar, të jemi më të vëmendshëm ndaj zhvillimeve në sistemin bankar, duke synuar të jemi të përgatitur për t'iu përgjigjur të gjitha sfidave. Për këtë është e rëndësishme të jemi vigjilentë dhe gati në çdo kohë për të përmbushur mandatin tonë ligjor, duke i dhënë depozituesve shqiptarë më shumë qartësi, qetësi dhe siguri, duke kontribuar kështu në qëndrueshmërinë e sistemit financiar e bankar në vend.

Në këtë frymë, kemi kënaqësinë t'ju prezantojmë Raporti Vjetor 2016 me ecurinë e depozitave në sistemin bankar dhe të fondit të sigurimit të depozitave në administrim të Agjencisë si dhe zhvillimet dhe projektet kryesore gjatë vitit.

Donald Duraj
Kryetar i Këshillit Drejtues

Genci Mamani
Drejtor i Përgjithshëm

1.2. Përmbledhje ekzekutive

Viti 2016 është karakterizuar nga rritja e depozitave në sistemin bankar, veçanërisht në pjesën e dytë të vitit. Në fund të dhjetorit 2016, totali i depozitave në sistemin bankar arriti 1,114 miliard lekë, krahasuar me 1,066 miliard lekë që ishte një vit më parë, duke shënuar një rritje prej 4.6 %. Vlera e depozitave të individëve që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 913 miliard lekë, 2.6% më shumë se një vit më parë. Depozitat e siguruara ishin në vlerën 611.4 miliard lekë duke përbërë 55% të totalit të depozitave ose 67% të vlerës së depozitave të siguruesshme të individëve. Vlera e depozitave të siguruara u rrit me 18.1 miliard lekë ose 3% krahasuar me një vit më parë. Numri i depozituesve individë që i kanë depozitat me vlerë deri në 2.5 milion lekë është 2,395,939 (përfaqësojnë 96% të depozituesve individë që përfitojnë nga skema), dhe krahasuar me një vit më parë ky numër u rrit me 12%.

Performanca financiare e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2016 është karakterizuar nga një rritje e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka. Në 31 dhjetor 2016, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka është 31.24 miliard lekë ose 12.9% më i madh se një vit më parë. Rritja e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka dhe ecuria e depozitave të siguruara në sistemin bankar kanë sjellë një rritje të vazhdueshme të raportit të mbulimit nga 2.01% në vitin 2009 në 5.11% në fund të vitit 2016. Raporti i mbulimit mbi 5% të depozitave të siguruara u arrit për herë të parë që nga krijimi i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Realizimi i këtij objektivi, si një tregues i përfshirë në Ligjin për Sigurimin e Depozitave, është i rëndësishëm sepse dëshmon për efikasitetin e skemës për t'ju përgjigjur detyrimeve ndaj depozituesve si dhe ecurinë pozitive të fondit të sigurimit të depozitave në banka ndër vite.

Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin në raportim, ishin 2.99 miliard lekë ose 3.2% më të larta se një vit më parë, në harmoni me rritjen e depozitave të siguruara në sistem. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2016 ishin 782.2 milion lekë. Në përmbushje të parametrave të përcaktuar në strategjinë afatmesme dhe planit vjetor, si dhe në kushtet e uljes së ndjeshme të normave të interesit, të ardhurat e Agjencisë në total u realizuan në masën 97.4% në krahasim me planin për vitin. Shpenzimet korrente janë realizuar në masën 92% në krahasim me planin. Këto shpenzime rezultuan sa 25.7% e të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare dhe 5.3% e të ardhurave në total.

Seksioni 2 - ASD fiton çmimin e IADI "Përmirësimet e Sistemit të Sigurimit të Depozitave".

Në takimin e përgjithshëm vjetor të Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI) që u zhvillua në Seul, Kore e Jugut, në datat 23-28 Tetor 2016, Agjencia e Sigurimit të Depozitave u shpall fituese e çmimit "Përmirësimet e Sistemit të Sigurimit të Depozitave". Më parë, ASD kishte aplikuar për këtë çmim, i cili vlerëson hapat e ndërmarrë nga skemat e sigurimit të depozitave për një periudhë tre vjeçare (përkatësisht tetor 2013 – tetor 2016) në drejtim të praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare të sigurimit të depozitave. ASD u vlerësua pozitivisht nga një komitet i posaçëm vlerësimi nga IADI në të gjitha rubrikat e paraqitura. IADI është organizata botërore me anëtarësinë e 83 shteteve që vendos standardet dhe parimet më të mira, nëpërmjet hartimit të parimeve themelore, në fushën e sigurimit të depozitave. Kjo organizatë ka marrë një rëndësi të veçantë në nivel ndërkombëtar, për shkak të rolit që luajtën skemat e sigurimit të depozitave në krizën financiare globale të vitit 2008 në drejtim të rritjes së besimit të qytetarëve, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit financiar të vendeve.

ASD u vlerësua për hapat e ndërmarra për implementimin e një sistemi IT për monitorimin e subjekteve anëtare të skemës dhe raportimin automatik të të dhënave, kalkulimin e primit të sigurimit, si dhe kompensimin e depozituesve në rast ngjarje sigurimi. Ky sistem elektronik zëvendëson një proces i cili më parë kryhej manualisht. Tanimë sistemi bën të mundur kompensimin e shpejtë dhe në kohë të depozituesve në rast nevoje.

Gjithashtu, ASD u vlerësua për një sërë reformash të rëndësishme ligjore që bënë të mundur modernizimin e skemës. U miratua ligji i ri "Për sigurimin e depozitave" i cili, ndër të tjera, bëri të mundur futjen në skemë të shoqërive kursim kredi, përshtatjen e niveleve maksimale të mbulimit për bankat dhe shoqëritë e kursim kreditit, prezantoi metodologjinë për kalkulimin e

primit të sigurimit dhe automatizimin e raportimit të të dhënave të depozituesve nga subjektet anëtare të skemës, si dhe përmirësoi pavarësinë financiare të Agjencisë dhe menaxhimin e fondeve prej saj. Me tej, ky ligj u ndryshua për të përfshirë personat juridikë dhe tregtarët në skemën e sigurimit të depozitave. Në vijimësi të këtyre ndryshimeve, Agjencia miratoi disa akte nënligjore, ndër të cilat Rregullorja e Kompensimit e cila detajon të gjithë hapat e një procesi kompensimi.

Së fundmi, ASD u vlerësua pozitivisht për fushatat e saj të ndërgjegjësimit të publikut dhe hapat e ndërmarra në këtë drejtim. Një hap i rëndësishëm ishte ndryshimi i imazhit të ASD, nëpërmjet krijimit të një logoje të re dhe prodhimit të fletëpalosjeve informative për depozituesit mbi funksionimin dhe objektivat e skemës së sigurimit të depozitave. Gjatë periudhës së vlerësimit, ASD gjithashtu prodhoi një video edukative për publikun si dhe rriti prezencën e saj në rrjetet sociale. Në vijimësi me ndryshimin e imazhit të, ASD gjithashtu riformatoi tërësisht faqen e saj zyrtare web, duke i ofruar përdoruesve një platformë moderne për informimin mbi veprimtarinë e ASD dhe funksionimin e skemës së sigurimit të depozitave.

Seksioni 3 - Vështrim i përgjithshëm mbi depozitat

3.1. Sistemi bankar, disa tregues kryesorë

Sistemi bankar në Shqipëri karakterizohet nga një qëndrueshmëri si në strukturë edhe në ecuri. Për sa i përket strukturës burimi kryesor i fondeve përbëhet nga depozitat e individëve, dhe mbështetja e aktivitetit me kapital mbetet në nivele të larta. Ecuria e aktiveve është në rritje dhe po në rritje mbetet niveli i kapitalit. Në vitin 2016 totali i depozitave në sistemin bankar u rrit me 4.6% krahasuar me vitin pararendës.

Në lidhje me raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, mbetemi në nivelet 15.71%, pra shumë më lart se minimumi i kërkuar prej 12%.

Grafiku 1. Struktura e bilancit dhe mjaftueshmëria e kapitalit[1]



[1] Burimi: Banka e Shqipërisë

3.2. Depozitat në sistem

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, totali i depozitave të sistemit ka patur trend në rënie me norma të ndryshimit mujor të ulëta, kurse gjatë gjysmës së dytë të vitit kjo ecuri ka qenë pozitive. Në fund të dhjetorit 2016, totali i depozitave në sistemin bankar arriti 1,114 miliard lekë, krahasuar me 1,066 miliard lekë që ishte një vit më parë, duke shënuar një rritje prej 4.6 %. Norma mesatare e ndryshimeve vjetore për shtatë vitet e fundit ishte 7.4 %.

Grafiku 2. Ecuria e depozitave të sistemit bankar për fund vitet 2002-2016



3.2. Depozitat e siguruesshme

Në fund të vitit 2016, vlera e depozitave të individëve që përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave arriti 913 miliard lekë, të cilat janë rritur me 23.6 miliard lekë ose 2.6% më shumë, krahasuar me vlerën prej 889 miliard lekë që ishte në fund të vitit të kaluar. Këto depozita përfaqësojnë 82% të totalit të depozitave. Numri i depozituesve individë që i mbajnë këto depozita, në fund të vitit 2016 është 2,487,953[2], dhe është rritur me 259,478 depozitues krahasuar me një vit më parë ose e shprehur në përqindje 12%. Gjatë periudhës 14 vjeçare të aktivitetit të skemës së sigurimit të depozitave për sistemin bankar, numri i depozituesve individë që përfitojnë prej saj është rritur rreth 6 herë (nga 400 mije depozitues në fillim të vitit 2003, në 2,487,953 në dhjetor 2016)

[2] Numri total i depozituesve është përcaktuar duke mbledhur të dhënat e agreguara të raportuara nga çdo bankë, kështu që një person i cili ka depozita në disa banka është regjistruar disa herë. Në këtë numër ka depozitues me balancë 0, në depozitat e tyre.

Depozitat e siguruesshme përfshijnë llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kartave, llogaritë e kursimit, depozitat me afat, llogaritë e përbashkëta dhe produkte të tjera të ngjashme. Vlera mesatare për kategorinë e depozitave të siguruesshme të individëve me vlerë më të madhe se 100 lekë, në fund të dhjetorit 2016 është 562 mijë lekë.

Grafiku 3. Ecuria e depozitave e strukturuar sipas përfitimit nga skema e sigurimit të depozitave (në % ndaj totalit të depozitave)



Në rritjen vjetore të depozitave të siguruesshme të individëve, ndikim më të madh kanë patur depozitat në monedhë të huaj, të cilat janë rritur më shpejt se depozitat në lekë (ndryshimi vjetor +4.4% kundrejt ndryshimit vjetor +1% të depozitave në lekë). Kurse sipas nivelit të mbulimit ndikim më të madh në rritjen vjetore të depozitave të siguruesshme të individëve e ka dhënë rritja e depozitave me vlera deri në nivelin e mbulimit (ndryshimi vjetor +3.3%, kundrejt ndryshimit vjetor +2.2% të depozitave mbi nivelin e mbulimit, 2.5 mln lekë).

Krahasuar me fundin e vitit 2003, që ishte vitit i parë i plotë i aktivitetit të skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, vlera e depozitave të siguruesshme të individëve është rritur më shumë se 3 herë, në termat nominalë.

Në fund të dhjetorit 2016, depozitat e siguueshme të individëve në lekë në sistemin bankar arritën shumën prej 458.1 miliard lekë duke përfaqësuar 50.2 % të depozitave të individëve dhe krahasuar me një vit më parë kanë shënuar një rritje në vlerë me 4.5 miliard lekë.

Grafiku 4. Struktura e shumës së depozitave të individëve të sistemit sipas monedhave në % - 31 dhjetor 2016



Depozitat në EUR, në fund të dhjetorit 2016, krahasuar me totalin e depozitave të siguueshme të individëve në monedhë të huaj, zënë peshën më të madhe prej 86.3%, të ndjekura nga depozitat në USD që kanë një peshë 10%. Depozitat në EUR të konvertuara në lekë arrijnë vlerën 392.6 miliard lekë, dhe janë rritur me 4.6% krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 5. Ecuria e depozitave të siguueshme të individëve të sistemit sipas monedhave gjatë vitit 2016



3.3. Depozitat e siguruara

Në fund të dhjetorit 2016 depozitat e siguruara ishin në vlerën 611.4 miliard lekë duke përbërë 55% të totalit të depozitave ose 67% të vlerës së depozitave të siguruesshme të individëve.

Depozita e siguruar është pjesa e depozitës së siguruesshme deri në nivelin e mbulimit, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 53/2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar . Depozitat e siguruara të sistemit në fund të vitit 2016 u rritën me 18.1 mld lekë ose 3% krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 6. Ecuria e depozitave të siguruara në vlerë dhe ndryshimi vjetor në % 2009-2016



Grafiku 7. Ecuria e depozitave të siguruara në vlerë për vitin 2016



Depozitat e siguruara që mbulohen plotësisht nga skema e sigurimit të depozitave (depozitat që janë ≤ 2.5 mln lekë) në 31 dhjetor 2016, arritën vlerën 381.4 miliard lekë dhe përfaqësojnë 42% të depozitave të siguruesshme të individëve ose 62% të depozitave të siguruara[3] (pjesa e mbetur e depozitave të siguruesshme përbëhet nga depozitat mbi nivelin e mbulimit). Krahasuar me një vit më parë këto depozita u rriten me 3.3% dhe rritja në vlerë është 12 miliard lekë.

Grafiku 8. Struktura e depozitave të siguruesshme krahasuar me limitin e mbulimit 2.5 mln- në Dhjetor 2016



Depozitat e siguruara pjesërisht (më të mëdha se 2.5 mln lekë) u rritën me 11.5 miliard lekë ose 2.2% krahasuar me një vit më parë, dhe në fund të dhjetorit 2016 arritën vlerën 531.6 miliard lekë.

Vlera mesatare për kategorinë e depozitave të siguruara plotësisht, por me vlera më të mëdha se 100 lekë është 249 mije lekë.

[3] Depozitat e siguruara përfaqësojnë detyrimin maksimal të Agjencisë kundrejt depozituesve individë.

Për periudhën 2009-2016, përqindja e depozitave të individëve me vlerë deri në 2.5 mln lekë, varion nga 40% deri në 48% të totalit të depozitave të siguueshme.

Grafiku 9. Ecuria e depozitave të individëve të klasifikuara sipas nivelit të mbulimit 2009-2016



Numri i depozituesve individë që i kanë depozitat me vlerë deri në 2.5 mln lekë është 2,395,939 (përfaqësojnë 96% të depozituesve individë që përfitojnë nga skema), dhe krahasuar me një vit më parë ky numër u rrit me 12%. Ndërsa numri i depozituesve individë që përfitojnë nga skema dhe vlerat e depozitave i kanë më të mëdha se 100 lekë, në fund të dhjetorit 2016 është 1,623,996.

Grafiku 10. Ecuria e numrit të depozituesve individë të klasifikuar sipas nivelit të mbulimit 2009-2016



Seksioni 4 – Administrimi i fondeve dhe burimeve financiare

4.1. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në banka

Në 31 dhjetor 2016, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 400 milion lekë dhe fitimet e akumuluara ndër vite, është 31.24 miliard lekë. Në krahasim me një vit më parë ky fond është rritur me 3.58 miliard lekë ose 12.9%. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e fondit të sigurimit të depozitave për periudhën 2009 – 2016. Gjatë kësaj periudhe fondi i sigurimit është rritur 295% nga 7.91 miliard lekë në fund të vitit 2009 në 31.24 miliard lekë në fund të vitit 2016.

Grafiku 11. Fondit i sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)



4.2. Ecuria e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK

Në përputhje me Ligjin 'Për sigurimin e depozitave', i ndryshuar, në Janar të vitit 2015, u arkëtua nga Buxheti i Shtetit fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK në vlerë 76 milion lekë. Ky fond, kontribut i Buxhetit të Shtetit, siguroi bazën fillestare financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK. Gjatë vitit 2015 dhe 2016, Agjencia ka administruar mjetet financiare të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, të cilat hynë në skemë në Janar 2017. Në 31 dhjetor 2016, vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, i cili përbëhet nga fondi themeltar prej 76 milion lekë dhe fitimet e akumuluara, është 80.6 milion lekë duke shënuar një rritje prej 6.05%.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, subjektet të cilat u pranuan për të hyrë në skemë nga Janari 2017, paguan në fund të vitit 2016 kontributet fillestar ndaj skemës. Vlera totale e kontributeve fillestare të arkëtuara është 2.75 milion lekë. Gjithashtu në harkun kohor të dy viteve fitimet nga investimi i mjeteve financiare, zbritur shpenzimet direkte në lidhje me administrimin e fondit dhe futjen e subjekteve në skeme, janë në vlerë 1.9 milion lekë.

4.3. Treguesit kryesorë financiarë

Fondi i sigurimit të depozitave në banka rritet ose zvogëlohet nga të ardhurat neto nga aktiviteti ndër vite. Të ardhurat kryesore që kontribuojnë në rritjen e fondit të sigurimit të depozitave në banka janë të ardhurat nga aktiviteti sigurues, primi vjetor i sigurimit dhe të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e të ardhurave kryesore për vitet 2009 - 2016.

Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2016 ishin 2.99 miliard lekë ose 3.2% më të larta se në vitin 2015. Të ardhurat nga primet e sigurimit përgjatë periudhës 2009 – 2016 kanë qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me rritjen e depozitave të siguruara në sistemin bankar në këto vite.

Grafiku 12. Primet e sigurimit në banka (në mijë lekë)



Deri në fund të vitit 2014, primi vjetor i sigurimit llogaritej nga bankat si 0.5% e mesatares aritmetike të gjendjes së depozitave të siguruara në fund të çdo dite pune të tre-mujorit të fundit të vitit të mëparshëm dhe paguhej nga këto subjekte në katër këste të barabarta. Pagesat e kësteve bëheshin nga subjektet jo më vonë se data 15 e muajve Prill, Korrik, Tetor, dhe Janar. Në përputhje me Ligjin "Për sigurimin e depozitave", duke filluar në vitin 2015 primi i sigurimit të depozitave përllogaritet nga bankat në baza tremujore dhe jo më vjetore. Për bankat primi tremujor i sigurimit përllogaritet si 0.125% e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të

siguruara, që janë regjistruar në bankë në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Primi tremujor i sigurimit për institucionet bankare paguhet jo më vonë se data 15 e muajit të parë të tremujorit për të cilin paguhet.

Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2016 ishin 782.2 milion lekë ose 10.5% më pak se në vitin 2015. Ky zë të ardhurash përgjatë periudhës 2009 – 2013 ka qenë në rritje, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me zgjerimin e mjeteve financiare nën administrim dhe normat e interesit të letrave me vlerë. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare për vitet 2014-2016 janë ndikuar nga ulja e normave të interesit të letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptarë. Në vitin 2016, ecuria e të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare u ndikua negativisht nga ecuria e normave të interesit dhe pozitivisht nga rritja e investimeve në maturitete afatgjata, veçanërisht maturitetet nga 12 muaj në 24 muaj, si dhe zgjerimi i mjeteve financiare.

Grafiku 13. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka (në mijë lekë)



4.4. Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara në banka

Në fund të vitit 2016, depozitat e siguruara në sistemin bankar ishin 611.4 miliard lekë ose 3.05% më të larta se një vit më parë. Rritja e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka dhe ecuria e depozitave të siguruara në sistemin bankar gjatë periudhës 2009 – 2016 kanë sjellë një rritje të vazhdueshme të raportit të mbulimit gjatë këtyre viteve. Në fund të vitit 2016, raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave në banka në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 5.11%. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e ecurisë së depozitave të siguruara në sistemin bankar dhe raportit të mbulimit përgjatë viteve 2009 – 2016.

Grafiku 14. Raporti i mbulimit dhe depozitat e siguruara në banka (në mijë lekë)



Në fund të vitit 2016, raporti i mbulimi mbërriti në mbi 5% të depozitave të siguruara për herë të parë që nga krijimi i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Realizimi i këtij objektivi, si një tregues i përfshirë në Ligjin për Sigurimin e Depozitave, është i rëndësishëm për efikasitetin e skemës për t'ju përgjigjur detyrimeve ndaj depozituesve si dhe i ecurisë pozitive të fondit të sigurimit të depozitave në banka ndër vite.

4.5. Administrimi i mjeteve financiare

Më 31 Dhjetor 2015, mjetet financiare të Agjencisë, me vlerë kontabël neto 31.24 miliard lekë, janë të investuara në masën më të madhe në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, Agjencia në përputhje me politikën e investimit mban jo më pak se 10% të portofolit në instrumente shumë likuid, si depozita me Bankën e Shqipërisë ose letra me vlerë

që maturojnë jo më vonë se 90 ditë nga momenti i blerjes nga Agjencia. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas llojit të instrumenteve më 31 Dhjetor 2016.

Grafiku 16. Mjetet financiare sipas llojit të instrumenteve



Mjetet financiare të Agjencisë janë në masën më të madhe në lekë. Agjencia mban edhe një pjesë të mjeteve të saj financiare në valutë Euro. Në përputhje me Politikën e Investimeve, investimet në monedhe të huaj nuk duhet të jenë më pak se 5% e mjeteve financiare nën administrim dhe në planin afatgjatë synohet afrimi i strukturës sipas monedhës për portofolin e Agjencisë me atë të depozitave të siguruara. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e mjeteve financiare të Agjencisë sipas valutës më 31 Dhjetor 2016.

Grafiku 17. Mjetet financiare sipas valutave



Bazuar në informacionin e mësipërm mbi mjetet financiare të Agjencisë, në grafikun e mëposhtëm paraqitet shpërndarja e mjeteve financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim më 31 Dhjetor 2016. Në funksion të administrimit me efektivitet të mjeteve financiare dhe të garantimit në çdo kohë të nevojave për mjete likuide financiare, mjetet financiare kanë një shpërndarje të shkallëzuar sipas kohëzgjatjes deri në maturim. Duke filluar nga gjashtëmujori i dytë i vitit 2014,

me miratimin e Ligjit nr. 53/14 "Për sigurimin e depozitave", Agjencia ka zhvendosur rreth 29% të portofolit të saj në instrumente me maturitet të mbetur mbi 12 muaj.

Grafiku 18. Mjetet financiare sipas kohëzgjatjes deri në maturim



4.6. Administrimi i burimeve financiare

4.6.1. Rregullorja e re "Për politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare"

Gjatë vitit 2016 Agjencia miratoi rregulloren e re "Për politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave". Kjo rregullore u hartua në zbatim të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave" të ndryshuar, rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2015", dhe zhvillimet e Parimeve Themelore për Sisteme Efikase të Sigurimit të Depozitave (Core Principles for Effective Deposit Insurance Systems).

Këto parime evidentojnë rëndësinë e mjeteve të gatshme në dispozicion; mekanizmat e financimit; marrëveshjet e financimit për të siguruar kompensim të shpejtë të depozituesve në rast të një ngjarjeje sigurimi, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Siguruesit e depozitave kanë përgjegjësi për investime të shëndetshme dhe një menaxhim efikas të fondeve të tyre. Për ketë është e rëndësishme një politikë investimi që siguron a) ruajtjen e kapitalit të fondit dhe sigurimin e likuiditetit dhe b) politikat e duhura në menaxhimin e rrezikut dhe procedurat e kontrollit të brendshëm që sigurojnë dhënien e informacioneve shpjeguese apo raportimeve. Risitë kryesore të kësaj rregullore në krahasim me të mëparshmen janë si më poshtë:

- Rritja e efikasitetit të kontrollit duke ndarë funksionet zbatuese nga ato monitoruese. Sektorit të Analizës së Riskut i qartësohen detyrat e monitorimit të pavarur nga Sektori i Financës dhe Investimeve, i cili është përgjegjës për zbatimin e politikës;

- Rishikimi dhe zgjerimi i funksioneve të Komitetit të Investimeve duke përcaktuar qartë rolin e tij jo vetëm në administrimin e mjeteve financiare por edhe në lidhje me burimeve financiare shtesë si dhe sigurimin e mjeteve likuide në rast ngjarje sigurimi;
- Vendosja e kritereve për përzgjedhjen e institucioneve financiare ndërkombëtare që kontraktohen për ruajtjen, tregtimit dhe ndërmjetësimit të titujve, si dhe përcaktimi i kompetencave në të gjitha nivelet për përzgjedhjen e këtyre institucioneve;
- Ndërtimi dhe përshtatja e strategjisë së administrimit të mjeteve dhe burimeve financiarë në bazë të vlerësimeve periodike mbi rrezikun që kanë subjektet anëtare.
- Thjeshtimi i administrimit të mjeteve financiare sipas transh-eve, ku trash-i i likuiditetit vendoset jo më pak se 10% e mjeteve financiare. Transh-it të investimit i rritet maturiteti maksimal nga 2 në 10 vjet, por investimet me maturitet mbi 2 vjet nuk mund të jenë më shumë se 30% e mjeteve financiare.

Rregullorja e re vendos parimet dhe qartëson më mirë kompetencat dhe procedurat, si dhe ofron dhe më shumë fleksibilitet në lidhje me administrimin efikas të portofolit për të adresuar zhvillimet e tregut si dhe zhvillimet në subjektet anëtare të skemës.

4.6.2. Marrëveshjet e huasë

Ligji për Sigurimin e Depozitave, në përputhje me parimet themelore dhe praktikat më të mira në fushën e sigurimit të depozitave, ka pajisur Agjencinë me aftësinë për t'ju drejtuar burimeve të ndryshme financiare më qëllim garantimin në çdo kohë të përmbushjes së detyrimeve të saj. Një ndër instrumentet më të rëndësishëm në dispozicion të Agjencisë është e drejta për të marrë hua.

Në fund të vitit 2014, Agjencia nënshkroi një marrëveshje huaje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për një linjë kredie deri në 100 milion EUR. Marrëveshja e huasë është shoqëruar me një garanci të Qeverisë Shqiptare. Sipas marrëveshjes, Agjencia paguan një komision angazhimi vjetor për këtë instrument sa 0.5% e shumës në dispozicion nga linja e kredisë. Në rast ngjarje sigurimi, Agjencia mund të aksesojë fondet në dispozicion nga linja e kredisë në një kohë të shkurtër duke rritur kështu efikasitetin e skemës për t'ju përgjigjur në kohë detyrimeve ndaj depozituesve. Me kërkesë të Agjencisë shuma në dispozicion nga linja e kredisë ulet pa kosto kur fondet e Agjencisë dhe raporti i mbulimit nga këto fonde rritet. Gjatë vitit 2016 si rezultat i rritjes së raportit të mbulimit, Agjencia uli shumën në dispozicion nga linja e kredisë në 58 milion EUR, çka ndikoi dhe në uljen e shpenzimeve financiare për këtë instrument në krahasim me një vit më parë. Ministria e Financave, në cilësinë e garantuesit, u informua dhe mori dijeni në lidhje me këtë ulje.

Seksioni 5 - Projektet kryesore për vitin në raportim.

5.1. Procesi i përfshirjes së SHKK-ve në skemën e sigurimit të depozitave.

Viti 2016 shënoi mbylljen me sukses të një procesi sfidues për përfshirjen e Shoqërive të Kursim-Kreditit, në skemën e sigurimit të depozitave. Zgjerimi i skemës së sigurimit të depozitave me këto institucione u realizua në zbatim të ligjit nr. 39/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/14, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave", si dhe në përputhje me rekomandimet e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

Procesi i përfshirjes së Shoqërive të Kursim-Kreditit në skemë, është kryer në konsultim dhe bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë. Marrja e informacionit për numrin e Shoqërive të Kursim-Kreditit që pas transformimeve mbanin ende licencën e marrë nga Autoriteti Mbikëqyrës, verifikimi i përbashkët në këto shoqëri, e deri marrja e vendimeve e dhënia e certifikatës së sigurimit të depozitave është bërë në këtë frymë bashkëpunimi.

Menjëherë me botimin në fletore zyrtare të ligjit nr. 39/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/14, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave", si dhe në vijim të vitit 2016, Agjencia ka kryer takime informuese me përfaqësues të të gjithë Shoqërive të Kursim Kreditit për plotësimin e kushteve për përfshirjen në skemë.

Fillimisht, u asistuan të gjitha SHKK-të e licensuara të dorëzonin brenda afatit kohor ligjor, 31 maj 2016, kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave.

Menjëherë pas kësaj u krye raundi i parë i verifikimit në të gjitha Shoqëritë e Kursim Kreditit që kishin dërguar kërkesën për anëtarësim në skemë. Në raportin e verifikimit u lanë rekomandime, me qëllim përmirësimin e punës për plotësimin e kërkesave për anëtarësim në skemë.

Pas afatit kohor të parashikuar në aktet nënligjore të Agjencisë, u krye raundi i dytë i verifikimit, në lidhje me korrigjimet e mangësive të gjetura në verifikimin e parë. Në përfundim dhe mbi bazën e këtij procesi, Këshilli Drejtues i Agjencisë mori vendimin për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe refuzimin e kërkesës për anëtarësim për ato Shoqëri të Kursim-Kreditit, të cilat nuk plotësonin kushtet.

Më datë 30 nëntor 2016, Agjencia e Sigurimit të Depozitave u dha certifikatën e sigurimit të depozitave Shoqërive të Kursim-Kreditit, të cilat plotësonin kushtet për anëtarësim në skemë. Nga trembëdhjetë Shoqëri të Kursim-Kreditit që paraqitën kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave, vetëm pesë prej tyre plotësuan saktë dhe në kohë të gjitha kushtet për anëtarësim.

Në mbështetje të këtij procesi, Agjencia ndërtoi shtesë në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim për SHKK-të. Ky sistem ka si objektiv kryesor qendërzimin e informacionit elektronik të raportuar në Agjenci nga SHKK-të, për llogaritjen e primit tremujor për secilën SHKK dhe kompensimin e shpejtë dhe efektiv në rast të një ngjarjeje sigurimi të një SHKK-je.

Ky projekt është mundësuar nga një grant i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe kontributit të FSVC, përmes ekspertëve të nivelit të lartë FDIC, për hartimin e termave të referencës.

5.2. Zgjerimi i skemës dhe përmirësimi e përshtatja e infrastrukturës ligjore dhe rregullative.

5.2.1. Përfshirja në skemë e tregtarëve dhe shoqërive tregtare.

Viti 2016 shënoi finalizimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave", të propozuar nga Agjencia në vitin 2015 me qëllim përfshirjen e depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare në skemën e sigurimit të depozitave. Kjo nismë ligjore mori shkas nga rekomandimet e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, datë 11.06.2015 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2014", si dhe ishte në përputhje me rekomandimet e Bankës Botërore në kuadër të planit të veprimeve për zbatimin e politikës së zhvillimit për modernizimin e sektorit financiar.

Projektligji kaloi fazat e shqyrtimit në komisionet parlamentare dhe në datën 14 prill 2016 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 39/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave", i cili hyri në fuqi më datë 24 Maj 2016.

Miratimi i këtij ligji mundësoi rritjen e bazës së depozituesve të mbrojtur nga skema e sigurimit të depozitave, duke kontribuar në forcimin e stabilitetit financiar në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, ligji përcaktoi dhe afatet ligjore të përfshirjes në skemë të shoqërive të kursim-kreditit me qëllim koordinimin e këtij procesi me atë të ristrukturimit të këtyre subjekteve. Anëtarësimi në skemë i shoqërive të kursim-kreditit si dhe përfshirja e depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare në depozitat e siguruesshme hyri në fuqi në mënyrë të njëkohshme më datë 1 janar 2017.

Gjatë vitit 2016, Agjencia ndërmori të gjitha masat përgatitore për t'i mundësuar subjekteve anëtare të skemës raportimin elektronik të depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim (SIRK) të Agjencisë. Për këtë qëllim, në modulet përkatëse të SIRK u shtuan fusha të reja në funksion të identifikimit të depozituesëve individë nga depozituesit tregtarë dhe shoqëri tregtare.

5.2.2. Roli i Agjencisë në ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka.

Një nga zhvillimet kryesore të skemës së sigurimit të depozitave gjatë vitit 2016 është miratimi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 132/2016 ""Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave" të ndryshuar"". Ky ligj është pjesë e paketës të ndryshimeve ligjore që u miratuan në funksion të zbatimit të ligjit nr. 133/2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë".

Gjatë vitit 2016, Agjencia ka luajtuar një rol aktiv në hartimin e paketës ligjore, duke qenë pjesë e grupit të punës të ngritur për këtë qëllim nga Banka e Shqipërisë. Ligji nr. 132/2016 ""Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave" i ndryshuar"", ka si qëllim të reflektojë disa ndryshime të nevojshme që lidhen me rolin e skemës së sigurimit të depozitave në zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka. Konkretisht, ndryshimet ligjore të miratuara përcaktojnë rolin e Agjencisë si administratore e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe se fondi i kompensimit të depozitave në banka mund të përdoret, me urdhër të Bankës së Shqipërisë në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me qëllim zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Dispozitat e ligjit nr. 132/2016 ""Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave" të ndryshuar, përcaktojnë një funksion të ri për Agjencinë, i cili është administrimi i fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ky fond do të krijohet me kontributet e bankave dhe do të përdoret në rast të zbatimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në një ose disa banka. Agjencia do të mbajë llogari të veçanta kontabël për mjetet dhe burimet financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme", të ndara nga mjetet dhe detyrimet e tjera të saj. Mënyra e administrimit të fondit do të përcaktohet me akt nënligjor të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Gjithashtu, Ligji nr. 132/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave" të ndryshuar"", përcakton se përdorimi i fondit të kompensimit të depozitave në funksion të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka i shërben ruajtjes së stabilitetit financiar dhe mbrojtjes së depozituesve të siguruar nga skema, duke i garantuar të drejtën e aksesit në depozitat e tyre. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr mendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë përpara se të urdhërojë përdorimin e fondit të kompensimit të depozitave në banka. Në çdo rast, shuma e pjesëmarrjes së fondit të kompensimit të depozitave gjatë kryerjes së procedurave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka nuk duhet të jetë më e madhe se detyrimet e Agjencisë në rastin e procedurave të likuidimit të detyruar si dhe jo më e madhe se 50% e fondit të kompensimit të depozitave në banka.

Ligji nr. 132/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave" të ndryshuar, hyn në fuqi 6 muaj nga botimi i tij në Fletoren zyrtare, njëkohësisht me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 133/2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë".

5.3. Forcimi i efikasitetit profesional dhe gatishmërisë

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 39/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave", në fokus të punës të Agjencisë ka qenë rishikimi i kuadrit nënligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë e sigurimit të depozitave nga subjektet anëtare të skemës, si dhe përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullativ lidhur me gatishmërinë operacionale të Agjencisë në rast ngjarje sigurimi. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2016 janë miratuar aktet nënligjore të mëposhtme:

5.3.1. Udhëzimi i Bankës së Shqipërisë nr. 4187, datë 1.09.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3241, datë 18.12.2014 "Për sigurimin e depozitave në banka".

Me propozimin e Agjencisë, Banka e Shqipërisë ka miratuar Udhëzimin nr. 4187, datë 1.09.2016 ""Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3241, datë 18.12.2014 "Për sigurimin e depozitave në banka"". Ky Udhëzim synon të pasqyrojë ndryshimet ligjore në skemën e sigurimit të depozitave në zbatim të Ligjit nr. 39/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014 "Për sigurimin e depozitave", veçanërisht për sa i përket sigurimit të depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare në bankat anëtare të skemës. Ndryshimet ligjore të miratuara ndër të tjera detajojnë kërkesat rregullatore për përfshirjen e depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare, si p.sh. në raportimin e të dhënave në sistemin elektronik për raportim dhe kompensim të Agjencisë, në përmbajtjen e aneksit të kontratës së depozitës për informimin e publikut, si dhe në përllogaritjen e primit për sigurimin e depozitave.

5.3.2. Udhëzimi i Bankës së Shqipërisë nr. 4188, datë 1.09.2016 "Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit".

Me propozimin e Agjencisë, Banka e Shqipërisë ka miratuar Udhëzimin nr. 4188, datë 1.09.2016 "Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit". Ky Udhëzim shfuqizoi udhëzimin e mëparshëm për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit. Miratimi i një udhëzimi të ri mori shkas kryesisht nga ndryshimet strukturore të SHKK-ve të parashikuara në ligjin nr. 52/2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", si dhe rishikimit të afateve ligjore të përfshirjes në skemë të shoqërive të kursim-kreditit në zbatim të ligjit nr. 39/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014 "Për sigurimin e depozitave". Udhëzimi i ri rregullon kushtet dhe procedurat e anëtarësimit të SHKK-ve në skemë, marrëdhënien e tyre me Agjencinë, si dhe kërkesat rregullatore për sigurimin e depozitave në këto subjekte.

5.3.3. Vendimi i Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 26, datë 17.10.2016 "Për miratimin e formatit standart të të dhënave për bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit".

Vendimi i Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 26, datë 17.10.2016 "Për miratimin e formatit standart të të dhënave për bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit" ka përcaktuar formatin standard të të dhënave që raportohen nga subjektet anëtare të skemës në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (SIRK). Raportimi elektronik i të dhënave për depozituesit është një detyrim ligjor që bankat dhe SHKK-të anëtare të skemës duhet të përmbushin në zbatim të nenit 25 "Detyrimet e subjekteve" dhe nenit 26 "Regjistri elektronik i detyrimeve depozitë të subjektit" të ligjit nr. 53/2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

5.3.4. Rregullorja nr. 3762, datë 18.7.2016 "Për kompensimin e depozitave të siguruara"

Me urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë është miratuar Rregullorja nr.3762, datë 18.7.2016 "Për kompensimin e depozitave të siguruara". Kjo rregullore hyri në fuqi më datë 13 gusht 2016 dhe është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

Objekti i saj është detajimi i rregullave dhe procedurave për realizimin e procesit të kompensimit, përzgjedhjen e bankës agjente dhe subjekteve mbështetëse, si dhe ndërveprimin e subjekteve të përfshira në këtë proces. Subjekte të kësaj rregulloreje janë subjektet anëtare të skemës, likuidatori, bankat agjente dhe subjektet mbështetëse të kontraktuara nga Agjencia, si dhe subjektet nën likuidim të detyruar.

Risitë kryesore që sjell rregullorja janë trajtimi i detajuar i fazës përgatitore për realizimin e procesit të kompensimit, kriteret dhe procedura për përzgjedhjen e bankës agjente dhe subjekteve mbështetëse, përdorimi i infrastrukturës informatike për gjenerimin e listëpagesës për kompensim, si dhe bashkëveprimi i subjekteve të përfshira në këtë proces.

Rregullimi i ri ligjor i procesit të kompensimit është me rëndësi prioritare pasi hap rrugën për pagesën e shpejtë dhe të saktë të depozituesve në rast të një ngjarjeje sigurimi, që është dhe objektivi parësor i skemës së sigurimit të depozitave në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar të vendit.

5.3.5. Plani i veprimit për kompensim

Gjatë vitit 2016, Agjencia ka punuar për hartimin e një drafti të planit të veprimit për kompensim. Ky plan detajon funksionet dhe detyrat e Agjencisë dhe sektorëve të saj në një ngjarje sigurimi. Plani i veprimit shtrihet në segmentin kohor nga informimi paraprak për mundësinë e ndodhjes

së një ngjarjeje sigurimi deri në përmbylljen e ekzekutimit të pagesave ndaj depozituesve. Ky dokument do të shërbejë për të përmirësuar efektivitetin e kapaciteteve të Agjencisë, për kryerjen e një procesi të shpejtë dhe të saktë kompensimi. Gjithashtu, plani i veprimit do të shërbejë si udhërrëfyes për kryerjen e simulimeve nga Agjencia, si dhe trajnimin e stafit të saj në funksion të gatishmërisë operacionale në një ngjarje sigurimi.

5.4. Administrimi financiar i Agjencisë

Përmbushja e misionit dhe objektivave ligjorë të Agjencisë në kuadër të ruajtjes të stabilitetit financiar dhe besimit të qytetarëve në të, ka si domosdoshmëri miradministrimin financiar të fondeve të sigurimit të depozitave. Agjencia është në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të efiçencës së saj operacionale dhe si rrjedhojë në Planin Strategjik për vitet 2015 – 2017 është përcaktuar si faktor kyç suksesi që, çdo vit, buxheti i realizuar të mos ketë shmangie më të lartë se 10% nga buxheti i miratuar. Arritja e këtij treguesi kërkon një angazhim gjithëpërfshirës të strukturave të Agjencisë në hartimin e një buxheti sfidues dhe realist, zbatimin e tij gjatë vitit dhe ndjekjen në kohë të realizimit të tij për të adresuar varianca të mundshme.

Përmbushja e objektivave ligjorë të skemës si dhe Planit Strategjik shoqërohen me ndikim financiar. Në hartimin e buxhetit Agjencia është e fokusuar për të vendosur fondet e nevojshme në përmbushje të objektivave të skemës si dhe administrojë me efikasitet mjetet financiare me qëllim zgjerimin e mëtejshëm të fondeve të sigurimit të depozitave. Monitorimi periodik i zbatimit të tij i mundëson drejtimit të vlerësojë punën e institucionit gjatë vitit, në përmbushje të objektivave të vendosur si dhe të ndërmarrë hapat e nevojshme për të adresuar çështje që kërkojnë vëmendje.

Në hartimin e buxhetit për vitin 2016, Agjencia synoi që shpenzimet korrente për vitin të ishin jo më të larta se 25% e planit të të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare. Këto shpenzime në raport me planin e të ardhurave në total ishin parashikuar në 5.6% të tyre. Strukturat e Agjencisë kanë vlerësuar që mbajtja e shpenzimeve brenda këtyre raporteve mundëson përmbushjen e objektivave si dhe garanton zgjerimin e fondeve të sigurimit të depozitave nga të ardhurat neto që realizohen gjatë vitit. Si rrjedhojë, planifikimi realist dhe realizimi i të ardhurave, veçanërisht atyre nga administrimi i mjeteve financiare, është kusht i rëndësishëm për zgjerimin e fondeve të sigurimit të depozitave si dhe përballimin e shpenzimeve në lidhje me objektivat dhe aktivitetin e Agjencisë për vitin.

Për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2016, të ardhurat në total u realizuan në masën 97.4% në krahasim me planin për vitin. Shpenzimet korrente janë realizuar në masën 92% në krahasim me planin. Plani i shpenzimeve kapitale për vitin 2016 u realizua në masën 81%, pasi disa nga projektet e planifikuara për vitin u shtynë në vitin pasardhës. Bazuar në të dhënat e mësipërme, shpenzimet korrente për vitin rezultuan sa 25.7% e të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare dhe 5.3% e të ardhurave në total.

5.5. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut

Ndërgjegjësimi i publikut lidhur me skemën e sigurimit të depozitave si dhe rolin dhe funksionet e Agjencisë është thelbësor jo vetëm për të menaxhuar sa më mirë një ngjarje sigurimi por ndikon edhe në forcimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

Agjencia gjatë këtij viti, bazuar në Strategjinë e ndërgjegjësimit të publikut miratuar nga Këshilli Drejtues në vitin 2016, ka qenë më aktive në fushatat për ndërgjegjësimin e publikut lidhur me skemën e sigurimit të depozitave në Shqipëri. Është punuar me grupet e synuara respektivisht për informim, komunikim dhe edukim. Duke analizuar tregun vendas dhe bazuar në të dhënat dhe eksperiencën e viteve te shkuara, Agjencia ka synuar që komunikimi me grupet e interesit t'i përgjigjet zhvillimeve të kohës dhe t'i përshtatet grupeve të synuara të përcaktuara, duke marrë në konsideratë profilet e tyre, nivelin arsimor, grup-moshat, nevojën për informim dhe komunikim, tolerancën ndaj rreziqeve të ndryshme, qëndrimet dhe perceptimet dhe pengesat në lidhje me secilin grup.

Duke pasur parasysh disa parime të rëndësishme që udhëheqin strategjitë e siguruesve të depozitave, sipas të cilave: (i) Publiku duhet të jetë i informuar në mënyrë të vazhdueshme dhe në kohë mbi skemën e sigurimit dhe kompensimit të depozitave; (ii) Agjencia duhet të ruajë transparencën në komunikim dhe besueshmërinë; (iii) Skema e sigurimit të depozitave duhet të prezantohet dhe promovohet në mënyrë të vazhdueshme, aktiviteti ndërgjegjësues/promovues i Agjencisë për vitin 2016 është orientuar në këto drejtime kryesore.

5.5.1. Zhvillimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me anëtarët e skemës dhe subjektet rregullatore financiare.

5.5.1.1. Trajnim me punonjës të bankave dhe SHKK-ve.

Në bashkëpunim me strukturat e tjera në Agjenci, për vitin 2016 janë organizuar trajnime me punonjësit e bankave dhe të SHKK-ve si dhe takime në terren me to. Punonjësit e bankave dhe SHKK-ve konsiderohen si partnerët strategjikë të Agjencisë në promovimin jo vetëm të produkteve të tyre por edhe në promovimin e skemës së sigurimit të depozitave. Punonjësit e tyre (në veçanti stafi operacional dhe punonjësit e sportelit) të cilët janë në shërbim të drejtpërdrejtë dhe kontakt me depozituesit, kanë rolin më të rëndësishëm në ofrimin e informacionit të saktë dhe të qartë depozituesve.

Fokusi i aktiviteteve të zhvilluara me bankat, në qytetet Durrës, Kavajë, Kukës, Peshkopi, Burrel dhe me SHKK-të në Elbasan, Berat, Lushnje, Durrës dhe Tiranë ishte:

- Rritja e nivelit të njohurive të punonjësve të tyre për elementet themelore të skemës së sigurimit;
- Bashkëpunimi me to për promovimin e skemës së sigurimit të depozitave.

Këto aktivitete ndihmojnë sepse audienca ka qasje të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e Agjencisë, duke mundësuar reagime të drejtpërdrejta dhe siguruar transparencë dhe besueshmëri

5.5.1.2. Bashkëpunimi me subjektet rregullatore të tregut financiar në vend.

Në kuadër të Javës Globale të Parasë, (një nismë ndërkombëtare, e cila synon edukimin financiar të publikut në përgjithësi dhe të brezit të ri më në veçanti) me iniciativë të Shoqatës Shqiptare të Bankave, dhe në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrinë e Arsimit dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, u organizuan aktivitete edukuese për fëmijë dhe të rinj si konkurse të shkollave të mesme, konkurse të studentëve të ekselencës, vizita në Muzeun e Bankës së Shqipërisë, vizita në banka të nivelit të dytë, seminare, leksione, etj. Agjencia, u përfaqësua në disa aktivitete gjatë këtij eventi të rëndësishëm, si në takimin me temë "Nevoja e një strategjie kombëtare për edukimin financiar", leksionin e hapur me studentët e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës dhe në konkurset e zhvilluara me nxënësit dhe studentët e UT.

5.5.2. Komunikimi i vazhdueshëm dhe efektiv me grupet e synuara.

5.5.2.1. Promovimi i skemës së sigurimit të depozitave dhe i ASD-së.

Në mënyrë që sistemi i sigurimit të depozitave të jetë efektiv është thelbësore që publiku të informohet në mënyrë të vazhdueshme lidhur me skemën e sigurimit të depozitave, përfitimet dhe kufizimet e saj. Duke pasur parasysh këtë, Agjencia ka përdorur mekanizmat e saj të informimit dhe komunikimit për të arritur depërtimin më të madh në të gjithë nivelet e publikut, depozitues apo jo, (duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si nivelin e arsimimit, interesat e grup kategorive, grup moshat, madhësinë e popullsisë, karakteristikat demografike, etj.).

i. Faqja zyrtare e internetit e Agjencisë

Si burim informacioni i sigurtë, i saktë dhe i besueshëm për publikun, faqja e internetit të Agjencisë pasqyron të dhëna për sistemin e sigurimit të depozitave në vend, njoftime të rëndësishme dhe aktivitete të Agjencisë. Gjatë vitit 2016, kemi qenë shumë aktiv në pasurimin e saj me të dhëna në ndihmë të depozituesve në veçanti dhe të publikut në tërësi. Janë publikuar në kohë reale aktet ligjore dhe nënligjore të reja si, Ligji "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar, "Udhëzim për sigurimin e depozitave në Banka", "Udhëzim për sigurimin e depozitave në SHKK" etj.

Numri i vizitorëve të faqes për vitin në fjalë është 9.135 dhe rubrikat janë shfletuar 30.853 herë.

ii. Profili i Agjencisë në rrjetet sociale

Profili Agjencisë në rrjetet sociale, si risi në fushën e komunikimit me publikun, është një mjet tjetër efikas për informim dhe edukimin e publikut. Profili ka zhvilluar përqasje më interaktive me të interesuarit, depozitues dhe më gjerë. Nëpërmjet korrespondencës me përdoruesit e tij,

(komenteve dhe pyetjeve), kemi vlerësuar perceptimet publike për institucionin dhe funksionet e tij, kemi orientuar depozituesit për të përfituar sa më shumë nga përparësitë e skemës, kemi korrigjuar perceptimet e gabuara dhe kemi parandaluar informacionin e rremë për skemën e sigurimit të depozitave. Duke i kushtuar rëndësi trendit gjithmonë e në rritje të rrjeteve sociale, Agjencia promovoi profilin e saj në platformën Facebook nëpërmjet fushatave në këtë rrjet. Nga monitorimi i ecurisë konstatojmë se rezultatet janë shumë pozitive. Numri i vizitorëve në nisje të periudhës ishte 1090 ndjekës dhe në përfundim të saj profili i Agjencisë numëron 5462 pëlqime dhe ndjekës.

5.6. Zhvillimi marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare të sigurimit të depozitave dhe agjencitë homologe

5.6.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë vitit 2016 Agjencia ka vazhduar të marrë pjesë dhe kontribuojë në të gjitha organizatat dhe forumet ndërkombëtare për sigurimin e depozitave, në të cilat aderon.

Si anëtare me të drejta të plota e IADI-t (International Association of Deposit Insurers) Agjencia ka kontribuar duke marrë pjesë në takimet dhe konferencat vjetore si dhe komitetet rajonale e të përhershme të organizatës. Konferenca e vjetore e IADI-t për vitin 2016, e cila është kthyer në një forum të rëndësishëm ku diskutojnë dhe prezantojnë politik bërës të nivelit të lartë, autoritete të sigurimit të depozitave dhe akademikë të shquar, organizohej me tematikën "Përgatitja për krizën e ardhshme". Në këtë konferencë u ndanë këndvështrime mjaft të detajuara për çështje të aktualitetit që lidhen me ekonominë globale, stabilitetin financiar dhe rolin thelbësor të siguruesve të depozitave në minimizimin e pasojave për ekonomitë vendeve të prekura nga krizat financiare. Kontributi i Agjencisë në kuadër të aktivitetit ndërkombëtar ka vijuar gjatë vitit 2016 edhe në vijim të përfshirjes se saj në Komitete dhe struktura të veçanta të IADI-t në shkallë rajonale e më gjerë, si Komiteti Rajonal i Evropës dhe Komiteti i Financës dhe Planifikimit.

Agjencia gjithashtu është anëtare me të drejta të plota e Forumit Evropian të Siguruesve të Depozitave (EFDI). EFDI është partneri kryesor i Komisionit Evropian për çështjet e sigurimit të depozitave. Në kuadër të zhvillimeve evropiane në disiplinën e sigurimit të depozitave, me miratimin e Direktivës 2014/59/EU, për Rimarrjen e Aseteve dhe Zgjidhjen e Bankave (Bank Recovery and Resolution Directive) dhe Direktivës 2014/49/EU për skemat e garantimit të depozitave, bashkëpunimi me EFDI ka një rëndësi parësore në funksion të aspiratave të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

5.6.2. Marrëveshja rajonale shumëpalëshe e bashkëpunimit.

Autoritetet ballkanike të sigurimit të depozitave, anëtare të EFDI, prej dy vjetësh kanë krijuar forumin e tyre me qëllim diskutimin e temave me interes të përbashkët.

Duke synuar ti japin një hov të mëtejshëm bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimit të ekspertizës, autoritetet e sigurimit të depozitave të Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë nënshkruan një Marrëveshje shumëpalëshe Bashkëpunimi. Marrëveshja u nënshkrua në Mars 2016 në Serbi.

Kjo Marrëveshje ka si qëllim ti mundësojë palëve nënshkruese krijimin e platformave të përbashkëta për të mbështetur interesat e përbashkëta në organizmat ndërkombëtare të anëtarësimit, kontributin e ndërsjellët sa i takon eksperiencës dhe ekspertizës, si dhe bashkëpunimin e ngushtë në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar në rajon. Autoritetet nënshkruese synojnë të realizojnë këto objektiva përmes shkëmbimit të informacioneve në lidhje me situatën në sektorët përkatës financiarë dhe bankarë, pjesëmarrjes në ushtrimet e simulimit të krizave, projekteve të përbashkëta kërkimore, përmirësimit të kuadrit rregullator dhe procedurave, ngritjes së grupeve të ekspertëve, shkëmbimit të personelit dhe organizmit të trajnimeve, etj.

Nënshkrimi i Marrëveshjes vlerësohet si një hap mjaft pozitiv në drejtim të koordinimit të veprimeve dhe aktiviteteve rajonale në përgjigje të sfidave të përbashkëta por edhe individuale më të cilat autoritetet mund të përballen për të përmbushur me sukses mandatin e tyre ligjor.

Seksioni 6 – Mirëqeverisja e organizatës

6.1. Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Këshilli Drejtues është përgjegjës për kryerjen dhe mirëfunksionimin e aktiviteteve dhe veprimtarisë së Agjencisë. Anëtarët e tij kanë detyrimin që në çdo kohë të veprojnë me ndershmëri në interesin më të mirë të Agjencisë. Roli i Këshillit përqendrohet në përgjegjësitë e tij mbikëqyrëse, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe duke vlerësuar performancën e drejtimit të Agjencisë përkundrejt kërkesave ligjore, rekomandimeve të institucioneve mbikëqyrëse (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Banka e Shqipërisë) si dhe objektivave të përcaktuara në planet strategjike dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Anëtarët e Këshillit Drejtues janë jo ekzekutiv, me përjashtim të anëtarit që emërohet në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm. Afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Drejtues është pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje, bazuar në treguesit e performancës të veprimtarisë së tyre.

Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar nga Autoriteti Mbikëqyrës dhe të propozuar si më poshtë:

KËSHILLI DREJTUES	FUNKSIONI	INSTITUCIONI PROPOZUES
Donald Duraj	Kryetar	Banka e Shqipërisë
Genci Mamani	Anëtar	Banka e Shqipërisë
Erjon Luçi	Anëtar	Ministri i Financave
Majlinda Dhuka	Anëtar	Ministri i Financave
Nexhmije Çela[4]	Anëtar	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)

Veprimtaria e Këshillit Drejtues për vitin 2016 është ushtruar në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin "Për Sigurimin e Depozitave", i ndryshuar, Statutin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Rregulloren "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave" dhe legjislacionin në fuqi për Organet Kolegjiale.

[4] Në detyrë nga data 21 qershor 2016.

Këshilli Drejtues në vitin 2016 zhvilloi 13 mbledhje, të cilat janë shoqëruar me vendimmarrjet përkatëse (47 vendime) në funksion të vendosjes dhe ruajtjes së standardeve të larta në mirëqeverisjen e Agjencisë si dhe konsolidimin e kapaciteteve të saj për të përmbushur mandatin ligjor.

Përgjatë vitit 2016 vendimmarrja e Këshillit u përqendrua kryesisht në miratimin e akteve nënligjore me qëllim zgjerimin e skemës së sigurimit të depozitave si dhe plotësimin e përmirësimin e kuadrit rregullator në funksion të gatishmërisë operacionale. Në vijim të miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 39/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave", Këshilli Drejtues shqyrtoi dhe miratoi (i) Projekt rregulloren "Për kompensimin e depozitave te siguruara"; (ii) Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Bankës së Shqipërisë nr. 3241, datë 18.12.2014 "Për sigurimin e depozitave në banka"; (iii) Projekt udhëzimin "Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit", të cilat më pas u miratuan nga Autoriteti Mbikëqyrës. Gjithashtu, ka marrë vendime shumë të rëndësishme sa i takon mbarëvajtjes operacionale të Agjencisë siç janë (iv) Miratimi i Rregullores "Për Politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave"; (v) Miratimi i strategjisë të ndërgjegjësimit të publikut"; (vi) Miratimi i rregullores "Mbi funksionimin e sistemit informatik për raportim dhe kompensim në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave". Në nëntor të vitit 2016, në zbatim të afateve ligjore dhe në vijim të procedurave të verifikimit për përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave Këshilli miratoi dhënien e vërtetimit dhe certifikatës për sigurimin e depozitave për 5 SHKK që plotësuan kërkesat ligjore dhe refuzoji kërkesën për anëtarësim për 8 SHKK, të cilat nuk plotësonin kërkesat e ligjit.

6.2. Struktura organizative

Agjencia vlerëson burimet e saj njerëzore si një nga faktorët më të rëndësishëm në arritjen me sukses të objektivave të përcaktuar.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore në Agjenci është i orientuar drejt identifikimit të nevojave të personelit, përmirësimit të aftësive profesionale të tyre nëpërmjet realizimit të trajnimeve në përshtatje me nevojat specifike të vendit të punës me qëllim përballimin e sfidave të ndryshme, administrimit me korrektësi të dosjeve të personelit, si dhe vlerësimit vjetor të performancës në punë për çdo punonjës, në kohë dhe në përputhje me rregullat administrative përkatëse.

Në organikën e saj Agjencia ka strukturën përkatëse për zhvillimin e burimeve njerëzore, e cila është struktura përgjegjëse për organizimin, drejtimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në përputhje me objektivat e Agjencisë. Aktualisht Agjencia funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendim Këshilli Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013

”Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”.



Sipas kësaj strukture organizative Agjencia është e përbërë nga 8 sektorë, me një staf prej 28 punonjësish. Gjatë vitit 2016 Agjencia ka plotësuar të gjitha pozicionet e punës duke mundësuar vijueshmërinë normale të funksioneve të saj me kapacitet të plotë. Procesi i rekrutimit synoi përzgjedhjen e një stafi të kualifikuar, me eksperiencë dhe aftësi profesionale, për të mbështetur nevojat dhe projektet e Agjencisë. Gjatë vitit 2016 Agjencia ka patur një qëndrueshmëri të vazhdimësisë së personelit, në vijim të politikave të saj për motivimin profesional të tyre.

6.3. Auditi i brendshëm

Aktiviteti i auditimit të brendshëm të Agjencisë për vitet 2014 – 2016 është realizuar nëpërmjet kontraktimit të këtij shërbimi me subjektin PricewaterhouseCoopers (PWC), anëtare e rrjetit PricewaterhouseCoopers International Limited, një nga katër kompanitë më të rëndësishme të auditit në botë, e cila garanton kryerjen e një shërbimi cilësor dhe sipas standardeve ndërkombëtare në fushën e auditit të brendshëm.

Vlerësimi i përgjithshëm i auditit të brendshëm në aspektin operacional të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe për përputhshmërinë me kuadrin ligjor e rregullator të Agjencisë për vitin 2016, është i kënaqshëm.

Ky subjekt, në cilësinë e auditit të brendshëm për vitin 2016, ka audituar Agjencinë në përputhje me bazën ligjore dhe rregullatore të përcaktuar në specifikimet teknike dhe planin vjetor 2016 miratuar nga Këshilli Drejtues. Prioritet në zbatimin e programit të auditit, ka qenë përcaktimi i procedurave dhe kontrolleve të domosdoshme për reduktimin e rreziqeve aktuale dhe atyre që mund të shfaqen në të ardhmen, të cilat përgjithësisht vlerësohen si pengesa në aktivitetin e

përditshëm të Agjencisë, në përmbushjen e funksioneve kryesore të saj, si dhe në realizimin e planeve strategjike të miratuara.

Në zhvillimin e aktivitetit gjatë vitit 2016, audituesit e PWC kanë kontrolluar sektorët kryesorë të Agjencisë si dhe procese pune të realizuara përmes komisioneve dhe grupeve të punës të ngritura gjatë vitit. Vlerësimi i sa më sipër, nga ekipi auditues, është bazuar në një metodologji analitike të përshtatshmërisë së të gjithë sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit në raport me afatet e përcaktuara në planin strategjik trevjeçar, përfshirë, ndër të tjera, kontrollet e brendshme mbi raportimin financiar, sistemet e teknologjisë së informacionit, etj.

Për secilin nga auditimet e kryera gjatë vitit sipas planit të miratuar, ekipi auditues ka përgatitur raporte të shkruar, në të cilët ka dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së Agjencisë dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm, me synimin për të ruajtur burimet, për të nxitur dhe inkurajuar performancën dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat. Në përfundim të çdo auditimi të kryer gjatë vitit sipas planit të miratuar, raportet e përgatitur në mënyrë profesionale dhe të pavarur, së bashku me komentet e strukturave drejtuese të Agjencisë, i janë paraqitur Këshillit Drejtues. Pjesë e raportimit të auditit të brendshëm në Këshill ka qenë edhe ndjekja e rekomandimeve të mëparshme, duke dhënë gjykime objektive, dhe duke siguruar që veprimet korrektuese ishin implementuar dhe kanë qenë efektive.